

**LIGJ**  
**Nr. 154/2020**

**PËR REGJISTRIN QENDROR TË LLOGARIVE BANKARE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1  
**Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave për krijimin e administrimit të Regjistrimit Qendror të Llogarive Bankare dhe kasetave të sigurisë, si një bazë e të dhënave shtetërore, si dhe detyrimin e institucioneve financiare për të raportuar të dhënat sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 2  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë, për pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, për parandalimin e financimit të terrorizmit, si dhe për lehtësimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore, taksave apo tarifave, në nivel qendror apo vendor.

Neni 3  
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet financiare, të cilat veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe ofrojnë shërbimet e llogarive bankare ose të kasetave të sigurisë për klientët e tyre.

Neni 4  
**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Regjistri” është Regjistri Qendror i Llogarive Bankare dhe i kasetave të sigurisë, si një bazë e të dhënave shtetërore, në të cilin regjistrohen e ruhen të dhënat, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në formë elektronike. Përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen në mënyrë të automatizuar, me ndërveprim, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, që lejon identifikimin në kohën e duhur të çdo

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën (BE) 2018/843 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit” dhe që ndryshon direktivat 2009/138/KE dhe 2013/36/BE. Numri CELEX 32018L0843, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 156, datë 19.6.2018, f. 43–74.

- Direktivën (BE) 2019/1153 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019 që vendos rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe që shfuqizon vendimin e Këshillit 2000/642/DÇB. Numri CELEX 32019L1153, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 186, datë 11.7.2019, f. 122–137.

individui, personi fizik ose juridik, që ka ose kontrollon llogari bankare të identifikuar nga IBAN dhe kasetat e sigurisë të mbajtura nga një institucion financiar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. “Llogari bankare” është llogaria e mbajtur nga një institucion financiar për një klient individ, person fizik ose juridik, e cila përfshin llogari depozitë, llogari rrjedhëse, llogari për kartë krediti, llogari pagese apo çdo lloj llogarie tjetër të ofruar nga një institucion financiar, pavarësisht statusit të saj: aktive, e bllokuar ose e fjetur.

3. “Kasetë sigurie” është kutia e sigurt, e vendosur zakonisht pranë një kasete bankare apo në një zonë sigurie të posaçme, me qëllim mbajtjen e sendeve me vlerë nga klientët.

4. “Mbajtës i llogarisë bankare” është individ, personi fizik ose personi juridik në emër të të cilit është e regjistruar llogaria bankare pranë një institucioni financiar.

5. “Institucion financiar” është çdo bankë ose subjekt financiar jo bankë, i cili, sipas legjislacionit në fuqi për bankat dhe për institucionet financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë, ofron kontrata të llogarive bankare apo shërbimin e kasetave të sigurisë dhe ka detyrimin për raportim sipas këtij ligji.

6. “IBAN” është numri identifikues ndërkombëtar i llogarisë bankare, i cili identifikon në mënyrë të qartë një llogari bankare individuale, elementet e së cilës përcaktohen nga standardet ndërkombëtare.

7. “Organizime ligjore” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

8. “Pronar përfitues” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për pronarët përfitues.

9. “Person i autorizuar” është çdo person, i cili në bazë të një marrëveshjeje ose akti përfaqësimi mund të kryejë veprime në emër të mbajtësit të llogarisë apo të kasetës së sigurisë.

10. “Subjektet e interesuara” janë subjektet që kanë akses në regjistër sipas niveleve të përcaktuara në këtë ligj ose në aktet nënligjore të tij si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- d) Byroja Kombëtare e Hetimit;
- dh) Shërbimi Informativ Shtetëror;
- e) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
- ë) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- f) drejtoritë e taksave dhe tarifave pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;
- g) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

11. “Subjekte që kanë të drejtë të marrin informacion” janë personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, të cilët, me kërkesë të argumentuar pranë institucionit administrues të regjistrit, kanë të drejtë të marrin informacion nga regjistri. Këto subjekte janë:

- a) shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror ose privat;
- b) institucionet financiare;
- c) çdo autoritet publik tjetër, që legjislacioni i posaçëm i jep të drejtën për të pasur informacion në regjistër.

12. “Vigjilenca e duhur” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

## Neni 5

### **Regjistri Qendror i Llogarive Bankare**

1. Regjistri krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku grumbullohet në formë të organizuar informacioni i ruajtur në formë elektronike për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të cilin regjistrohen të dhënat e raportuara nga institucionet financiare.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e regjistrit.

3. Subjekteve të tjera të interesuara u garantohet e drejta e aksesit vetëm për ato të dhëna të regjistrit që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale sipas legjislacionit të zbatueshëm.

4. Niveli i aksesimit, sipas pikës 3 të këtij neni, për subjektet e interesuara të përcaktuara në pikën 10 të nenit 4 të këtij ligji, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Informacioni i ruajtur në regjister nuk është i disponueshëm për publikun.

#### Neni 6

### **Krijimi dhe administrimi i regjistrit**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni administrues i regjistrit.

2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është përgjegjëse për krijimin e sistemit, në mënyrë që të garantojë masat e përshtatshme për sigurinë e të dhënave, si dhe parimet e mjaftueshmërisë e proporcionalitetit lidhur me përpunimin e të dhënave.

#### Neni 7

### **Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim të këtij ligji, është përgjegjëse për:

- a) vënien në dispozicion të aksesit të regjistrit për subjektet e interesuara;
- b) mbikëqyrjen e përputhshmërisë së institucioneve financiare me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;
- c) dhënien e informacionit për subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion me kërkesë, sipas pikës 11 të nenit 4 të këtij ligji;
- ç) kryerjen e veprimtarive në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kërkesa dhe dhënia e informacionit, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, realizohen sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion me kërkesë duhet të ruajnë të dhënat e përdorura, sipas kësaj pike, për një periudhë 10-vjeçare.

#### Neni 8

### **Të dhënat e regjistrit**

1. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme për mbajtësit individualë të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë:

- a) emrin e mbiemrin e mbajtësit/mbajtësve të llogarisë bankare ose të individit, i cili ka apo i është vënë në dispozicion kasetat e sigurisë;
- b) numrin e llogarisë bankare dhe kodin IBAN të llogarisë në rastet kur është llogari bankare;
- c) numrin e identifikimit ose kodin identifikues të saj në rastet kur është kasetë sigurie;
- ç) emrin e institucionit financiar që mban llogarinë bankare ose kasetën e sigurisë;
- d) datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të mbajtësit të llogarisë bankare ose qiramarrësit të kasetës së sigurisë;
- dh) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo personi, që vepron në emër të mbajtësit të llogarisë bankare ose qiramarrësit të kasetës së sigurisë;
- e) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo individit që ka përfitim në llogari dhe/ose që është person i lidhur me mbajtësin e llogarisë, kasetat e sigurisë ose qiramarrësit e tyre;

ë) numrin personal të identifikimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe ekuivalentin e tij për shtetasit e huaj, nëse ka;

f) statusin e llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

g) datën e hapjes së llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

gj) datën e mbylljes, nëse llogaria ose kasete e sigurisë është mbyllur; dhe

h) numrin e llojin e dokumentit të identifikimit të vlefshëm të përdorur në institucionin financiar gjatë procesit të vigjilencës së duhur.

2. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme kur një person fizik, person juridik ose organizim ligjor është mbajtës i llogarisë bankare ose qiramarrës i një kasete sigurie:

a) emrin e mbajtësit të llogarisë ose të qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

b) numrin e llogarisë bankare dhe kodin IBAN të llogarisë në rastet kur është llogari bankare;

c) numrin e identifikimit ose kodin identifikues të saj në rastet kur është kasetë sigurie;

ç) emrin e institucionit financiar që mban llogarinë bankare ose kasetën e sigurisë;

d) selinë e regjistruar të personit fizik, të personit juridik ose të organizimit ligjor dhe, nëse është e ndryshme, vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit;

dh) numrin unik të identifikimit të subjektit për personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si dhe ekuivalentin e tij për subjektet e huaja;

e) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo personi që është i autorizuar të veprojë në emër të mbajtësit të llogarisë ose të qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

ë) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e çdo individi pronar përfitues në llogarinë ose mbajtësin e llogarisë, kasetës së sigurisë ose qiramarrësit të saj;

f) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e themeluesit, të përfituesve dhe të personit të autorizuar/të besuarit në rastet kur është një organizim ligjor;

g) numrin personal të identifikimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe ekuivalentin për shtetasit e huaj, nëse ka, për pronarët përfitues, themeluesit, përfituesit dhe personat e autorizuar;

gj) statusin e llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

h) datën e hapjes së llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

i) datën e mbylljes nëse llogaria është mbyllur; dhe

j) numrin e llojin e dokumentit të identifikimit të vlefshëm të përdorur në institucionin financiar gjatë procesit të vigjilencës së duhur.

3. Për qëllime të administrimit të regjistrit, të dhënat e tij klasifikohen në të dhëna parësore e dytësore si më poshtë:

a) të dhëna parësore konsiderohen:

i. numri identifikues në regjistër i llogarisë;

ii. numri identifikues në regjistër i institucionit financiar;

b) të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.

4. Regjistri nuk përmban të dhëna për gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kasetave të sigurisë. Institucionet financiare nuk raportojnë të dhëna për gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kasetave të sigurisë.

## Neni 9

### Raportimi i të dhënave

1. Institucionet financiare duhet të krijojnë dhe të administrojnë sisteme që sigurojnë raportimin e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 8 të këtij ligji, në kohë reale, pas përfundimit të veprimeve me mbajtësit e llogarisë bankare ose të kasetave të sigurisë.

2. Institucionet financiare i raportojnë të dhënat në regjistër në mënyrë elektronike, duke përdorur mekanizmin qendror të automatizuar sipas formatit të skedarit të raportimit.

3. Formati i skedarit të raportimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, i cili hartohet në konsultim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

#### Neni 10

### **Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimit për raportim**

1. Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimit për raportim dhe e përputhshmërisë së të dhënave bankare të raportuara nga institucionet financiare realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria nuk e delegon këtë kompetencë pranë degëve të saj rajonale.

2. Mbikëqyrje, sipas këtij ligji, është verifikimi i procesit të raportimit kur institucionet financiare nuk raportojnë të dhënat dhe verifikimi i saktësisë së të dhënave kur konstatohet mospërputhje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo kur kjo e fundit ka dijeni për mospërputhje nga burime të ligjshme.

3. Për qëllimet e këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:

a) mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së institucioneve financiare me kërkesat e këtij ligji;

b) kërkon nga çdo institucion financiar akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti, përfshirë kopje të tyre, që ka të bëjë me të dhënat sipas nenit 8 të këtij ligji, që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të institucioneve financiare në zbatim të këtij ligji;

c) mbikëqyr mënyrën e saktësinë e raportimit të të dhënave nga institucionet financiare;

ç) mund të urdhërojë institucionet financiare të ndërpresin çdo praktikë që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 11

### **Detyrimi për ruajtjen e të dhënave**

1. Të gjitha të dhënat e administruara nga regjistri dhe dokumentacioni tjetër ligjor ruhen të plota nga institucionet financiare për 10 (dhjetë) vjet nga mbyllja e llogarisë bankare ose e kasetës së sigurisë.

2. Në përfundim të afatit të ruajtjes së të dhënave personale, këto të dhëna fshihen nga regjistri.

3. Përpunimi i të dhënave personale dhe informimi i subjektit të të dhënave personale nga ana e institucioneve financiare kryhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 12

### **Marrja e të dhënave për qëllime statistikore**

1. Organet publike që janë përgjegjëse për publikimin e statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për statistikat zyrtare, mund të kërkojnë informacion nga regjistri për t'u përpunuar për qëllime statistikore.

2. Informacioni i kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, jepet vetëm në formë të anonimizuar.

#### Neni 13

### **Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave në regjistër**

1. Institucionet financiare janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të raportuara në bazë të këtij ligji dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim. Nëse institucionet financiare zbulojnë se ndonjë prej të dhënave të raportuara për qëllim të këtij ligji

është e pasaktë ose e paplotë, njoftojnë menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë, njësinë përgjegjëse për regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke marrë masa njëkohësisht për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota dhe duke i raportuar ato sërish.

2. Nëse organet që kanë akses në të dhënat e këtij regjistri vërejnë se të dhënat e raportuara apo të mbajtura në regjistër janë të pasakta apo të paplota, njoftojnë pa vonesë njësinë përgjegjëse për regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila merr masa për komunikimin me institucionin financiar raportues e korrigjimin e pasaktësive të konstatuara.

#### Neni 14

### **Përdorimi i të dhënave të marra në regjistër**

Të dhënat e mbajtura në regjistër përbëjnë sekret bankar e profesional dhe duhen trajtuar e ruajtur si të tilla nga të gjitha autoritetet që kanë akses në to.

#### Neni 15

### **Përjashtim nga e drejta për informim**

Legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë nuk është i zbatueshëm për informacionin e mbajtur në regjistër dhe përdorimin e tij nga autoritetet përgjegjëse.

#### Neni 16

### **Publikimi i të dhënave vjetore për përdorimin e regjistrit**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon brenda tremujorit të parë të çdo viti raportin publik vjetor për vitin pararendës për përdorimin e regjistrit. Raporti duhet të përfshijë edhe statistika të hollësishme të anonimizuara për numrin e organeve, të cilat kanë aksesuar në regjistër, duke përfshirë numrin e personave të kërkuar prej tyre.

#### Neni 17

### **Kundërvajtjet administrative**

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) mosdërgimi i informacionit dhe i të dhënave në mënyrën e përcaktuar në pikën 2 të nenit 9 të këtij ligji, ose raportimi i të dhënave të rreme në regjistër nga institucionet financiare dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

b) mosmarrja e masave nga ana e institucioneve financiare për korrigjimin e gabimeve në të dhënat e raportuara në regjistër, qofshin këto të konstatuara vetë apo të evidentuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

c) përdorimi i të dhënave nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

ç) përdorimi i paautorizuar i të dhënave nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj ose përdorimi i të dhënave në kundërshtim me qëllimin e dispozitatave të këtij ligji dhe të akteve të tij nënligjore, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Gjoha vendoset nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Format i modelit të gjobës sipas këtij neni përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

4. Kundër vendimit të dhënë për vendosjen e gjobës mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

#### Neni 18

### **Përgjegjësia në rastin e forcave madhore**

1. Institucionet financiare nuk mbajnë përgjegjësi për mospërbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të trazirave të tjera civile dhe fatkeqësive natyrore.

2. Institucioni financiar që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet në përputhje me këtë ligj për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, njofton me shkrim menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkakun e shkallën e problemit që e ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve, si dhe bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur.

#### Neni 19

### **Dispozitat e fundit**

1. Institucionet financiare të identifikojnë, të krijojnë e të mbajnë dokumentet përkatëse për mbajtësit e llogarive bankare brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit ndërton regjistrin brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Institucionet financiare duhet të transmetojnë të dhënat e kërkuara nga ky ligj për mbajtësit e llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit.

4. Raportimi i parë i institucioneve financiare duhet të përfshijë edhe të dhënat për llogaritë bankare ose kasetat e sigurisë të mbyllura 5 vitet e fundit. Përfundimisht, për llogaritë e mbyllura përpara datës 1.1.2020, institucionet financiare raportojnë ato të dhëna që disponojnë.

#### Neni 20

### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë udhëzimin në zbatim të pikës 3 të nenit 9 të këtij ligji.

3. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë urdhrin në zbatim të pikës 3 të nenit 17 të këtij ligji.

#### Neni 21

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11910, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Ilir Meta**